KËRKESË
Nr.1312, datë 15.3.2011

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Kuçovë-Belsh-Cërrik" (loti I-5 km).

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim.

Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtën të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike dhe Transportit).

Sqarojmë që kjo shpallje kërkese për shpronësim bëhet për pasurinë e llojit: tokë arë, objekt truall dhe kultura bujqësore. Kompensimi për efekt shpronësimi do të bëhet pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi pronarët e pasurive të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë të rifreskuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik").

Vlera totale e shpronësimit për: tokë arë, truall, objekt, kultura bujqësore dhe dru frutorë është 5 258 997 (pesë milionë e dyqind e pesëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi